



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
GJIMNAZI "MYSLYM SHIMA" YZBERISHT

Nr. 144 prot

Tirane ,me 03.06.2015

LËNDA: NJOFTIM PËR VËND TË LIRË PUNE

Drejtoria e shkollës së mesme "Myslim Shima" Yzberisht në zbatim të Ligjit Nr.69/2012 ,date 21.06.2012 " Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë " , të VKM Nr .66 , datë 03.02.2010 " Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore " si dhe të udhezimit nr.58 , date 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar " ,shpall konkursin për vend të lire pune në pozicionin Nëndrejtor i Institucionit Arsimor Publik në :

Shkollën e Mesme "Myslim Shima" Yzberisht .

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

Kandidati /ja për nëndrejtor I institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a) Te ketë diplomë të nivelit të dytë në fushen e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve te Ligjit nr.9741 , datë 21 .05 .2007 " Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë ,të ndryshuar (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë) .
- b) Të ketë të paktën kategorinë "mësues i kualifikuar " dhe në provimin e kualifikimit të jetë vlersuar "shumë mirë" ose "mirë" (fotokopje e noterizuar e dëshmisë së kualifikimit)
- c) Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij (nëse nuk ka ,e deklaror me shkrim që nuk ka) .

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati /ja për nëndrejtor I institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a)CV- në dhe kopje të dokumentave që vërtetojnë pohimet në CV(sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1 , bashkëllidhur këtij udhëzimi .)
- b) Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo me herët se tri muaj para datës së aplikimit.


c) Deklaratën personale që vërteton se nëndrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit .(bashkëshort /te ,prind , vëlla/motër , fëmijë në moshë madhore etje.)

ç)Dy rekomandime nga mësues ose drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të njësisive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë vitëve të fundit (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.3 , bashkëlidhur këtij udhëzimi .)

Dokumentacioni i aplikimit ,i përcaktuar në pikën 1 ,dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor publik .

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë pas shpalljes së kërkesës për nëndrejtor .

Konkurimi do të zhvillohet në ambjentet e shkollës së mesme “Myslim Shima” ,Yzberisht ,Tiranë në datën , 12 , 06 , 2015



DREJTORI
Mira HOXHA